



**Republika e Kosovës  
Komuna e Drenasit  
Kuvendi i Komunës**



Nr 02-170/06-56108 dt. 27/10/2022

Bazuar në nenin 11,12, dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, bazuar në nenin 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë, **27. 10.2022**, miratoi këtë:

**V E N D I M**

**Për shpalljen e SH.T. Z. Prof. Dr. Bajram Begaj "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit**

**Neni 1**

Më këtë Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës shpallja e SH.T.Z. Prof. Dr. Bajram Begaj "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.

**Neni 2**

Titulli "Qytetar Nderi" SH.T.Z. Prof. Dr. Bajram Begaj i jepet për kontribut të shquar për Republikën e Kosovës dhe qytetarëve të saj, para luftës tonë çlirimtare dhe në veçanti gjatë luftës çlirimtare, si drejtues shëndetësor, për ushtarët e plagosur të UÇK-së.

**Neni 3**

Titulli Qytetar Nderi sipas këtij Vendimi do të ndahet nga kryetari i komunës, i cili autorizohet të përcaktoj formën e dekoratës, mënyrën e dhënies si dhe çështjet tjera sa i përket organizimit të ndarjes së titullit.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

**Neni 5**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:  
Zyrës së Kryetarit ;  
Drejtorisë Përkatëse;  
Zyrës së Kuvendit;  
Arkivit;  
Palës;



**Kryetari i Kuvendit të Komunës**

**Milaim Hajdari**

## ARSYETIM

SH.T.Z. Prof. Dr. Bajram Begaj, është Presidenti i 8-të i Republikës së Shqipërisë, prej 24 korrik 2022.

Ka lindur në qytetin e Rrogozhinës më 20 mars 1967.

Presidenti Begaj ka përfunduar studimet për mjekësi në Universitetin e Tiranës dhe i është bashkuar radhëve të Forcave të Armatosura Shqiptare, si mjek ushtarak në specializimin Gastro-Hepatologji.

Me një karrierë të gjatë ushtarake prej 32 vjetësh ka mbajtur disa poste të rëndësishme, dhe është vlerësuar me disa medalje për arritjet e tij.

Në vitin 2020, një muaj pas gradimit si Gjeneral Major, shërbeu si Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ka përfunduar studimet doktorale dhe është autor i disa publikimeve shkencore. Prej vitit 2016, mban gradën shkencore Profesor i Asociuar.

Presidenti Bajram Begaj është i martuar me zonjën Armanda Begaj dhe kanë dy djem, Dorianin dhe Klajdin.

Sh. T. Z. Bajram Begaj, me përkushtimin e tij profesional e atdhetar, ka dhënë kontribut të shquar për Republikën e Kosovës dhe qytetarëve të saj, para luftës tonë çlirimtare dhe në veçanti gjatë luftës çlirimtare, si drejtues shëndetësor, për ushtarët e plagosur të UÇK-së.

Presidenti Begaj, sot, në krye të shtetit, me agjendën e tij, mbron interesin e shqiptarëve kudo jetojnë, duke promovuar të drejtat dhe duke mbrojtur vlerat e shqiptarëve kudo jetojnë, si kontribuues të paqes dhe mirëkuptimit.

Kryetari i komunës së Drenasit, me krenari do të propozojë që ish presidentët dhe Sh. T. Z. Bajram Begaj, të shpallet “Qytetar nderi” i komunës së Drenasit, me qëllimin e përafrimit të vlerave, njohjes dhe promovimit të kontribuuesve institucional.